

**KODI  
PENAL  
i RPSSH**

**KODI PENAL  
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

**15-6-1977**

**KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS  
POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Miratimin e Kodit Penal të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

**PJESA E PËRGJITHSHME  
KREU I PARË**

**Neni 1**

**Detyrat e legjislacionit penal**

Legjislacioni penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë shpreh vullnetin e klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse, është armë e fuqishme e diktaturës së proletariatit në luftën e klasave.

Legjislacioni penal ka për detyrë të mbrojë shtetin socialist, Partinë e Punës të Shqipërisë si forcë e vetme politike udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë, pasurinë socialiste, të drejtat dhe interesat e shtetasve, gjithë rendin shoqëror socialist nga veprat shoqërisht të rrezikshme me anë të zbatimit të dënimeve kundër atyre që i kryejnë ato.

Detyrë e rëndësishme e legjislacionit penal të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë është lufta kundër burokratizmit dhe liberalizmit, si rreziqe kryesore për shtetin e diktaturës së proletariatit.

Legjislacioni penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë ka për detyrë, gjithashtu, tëndihmojë për ndërtimin e plotë të socializmit e të komunizmit sipas parimit të mbështetjes në forcat e veta dhe të ndikojë për edukimin e shtetasve me frymën e respektimit të ligjshmërisë socialiste.

## **Neni 2**

### **Bazat e legjislacionit penal**

Legjislacioni penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë udhëhiqet nga politika e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëhiqet nga politika e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe bazohet në ideologjinë e klasës punëtore në marksizëm-leninizmin.

Legjislacioni penal buron nga Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

## **Kreu i dytë**

### **Vepra penale (Krimi)**

## **Neni 3**

### **Kuptimi i veprës penale**

Vepër penale është çdo veprim ose mosveprim shoqërisht i rrezikshëm, i kryer me faj dhe i parashikuar nga ligji.

Është shoqërisht e rrezikshme vepra e drejtuar kundër shtetit socialist, Partisë së Punës të Shqipërisë, pasurisë socialiste, personit, të drejtave dhe intersave të tij, gjithë rendit shoqror socialist.

Nuk është vepër penale, ajo që ndonëse parashikohet nga një dispozitë e ligjit penal, nuk është shoqërisht e rrezikshme për shkak të rëndësisë së saj të vogël.

## **Neni 4**

Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi ndërmjet krimit dhe kundërvajtjes penale bëhet në çdo rast nga ligji penal në bazë të shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale.

## **Neni 5**

### **Lidhja shkakësore**

Personi ka përgjegjësi penale, kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave shoqërisht të rrezikshme ka lidhje shkakësore.

## **Neni 6**

### **Faji**

Personi ka kryer një veprim ose mosveprim me faj kur:

- a) ka parashikuar pasojat shoqërisht të rrezikshme të veprës së tij dhe i ka dëshiruar ato ose me vetëdije ka lejuar ardhjen e tyre (me dashje);
- b) Ka parashikuar se nga vepra e tij mund të vijnë pasoja shoqërisht të rrezikshme, por me mendjelehtësi ka shpresuar t'i ndalojë ose nuk i ka parashikuar këto pasoja, megjithëse, sipas rrethanave të çështjes, mund dhe duhej t'i parashikonte (me pakujdesi).

## **Neni 7**

### **Mosha për përgjegjësi penale**

Ka përgjegjësi penale persini, i cili, kur ka kryer veprën penale, ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç.

## **Neni 8**

### **Personat e papërgjegjshëm**

Nuk ka përgjegjësi penale personi, i cili, kur ka kryer veprën penale, nuk ka pasur vetëdijen e rëndësisë së saj ose nuk ka mundur të kontrollojë veprimin ose mosveprimin e tij për shkak të sëmundjes psikike, të zhvillimit mendor të metë ose të ndonjë sëmundjeje tjetër që shoqërorhet me turbullime psikike.

Efektet e kësaj dispozite nuk shtrihen mbi personat që kanë kryer veprën penale duke qenë të dehur.

## **Neni 9**

### **Mbrojtja e nevojshme**

Vepra e kryer për të mbrojtur shtetin socialist, Partinë e Punës së Shqipërisë, pasurinë socialiste, personin, të drejtat dhe interesat e tij, gjithë rendin shoqëror socialist nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit, kur nuk kapërcehen kufijtë e mbrojtjes së nevojshme, megjithëse parashikohet nga ligji penal, nuk sjell përgjegjësi penale.

## **Neni 10**

### **Nevoja ekstreme**

Vepra e kryer për të prapsur një rrezik të vërtetë dhe të çastit që i kanoset shtetit socialist, Partisë së Punës të Shqipërisë, pasurisë socialiste, personit, të drejtave dhe interesave të tij, gjithë rendit shoqëror socialist, në qoftë se rreziku nuk mund të prapëj në ato rrethana me mënyra të tjera, kur dëmi i shkaktuar është më i vogël se dëmi i prapsur, megjithëse parashikohet nga ligji penal, nuk sjell përgjegjësi penale.

Nuk është në gjendje nevoje ekstreme personi që ka për detyrë të vihet në rrezik dhe, megjithëkëtë shmanget, duke shkelur detyrat e tij shtetërore ose profesionale.

## **Neni 11**

### **Përgatitja dhe tentativa**

Përgatitje quhet krijimi i kushteve për kryerjen e një krimi.

Tentative quhet veprimi që ka synuar drejtpërsëdrejti kryerjen e veprës penale, në qoftë se kjo nuk është kryer.

Përgatitja dhe tentativa dënohen sipas dispozitës së ligjit penal që parashikon veprën penale që do të kryhej.

Në caktimin e dënimit për përgatitje dhe tentativë gjykata duhet të marrë parasysh shkallën e përgatitjes së veprës, afërsinë e ardhjes së pasojave, si edhe shkaqet për të cilat nuk u krye vepra dhe mund të ulë dënimin nën minimumin e parashikuar nga ligji penal për atë vepër.

## **Neni 12**

### **Heqja dorë nga kryerja e veprës penale**

Personi që vullnetarisht heq dorë në mënyrë përfundimtare nga kryerja e një vepre penale megjithë pundësitë që ka për kryerjen e saj, nuk ka përgjegjësi penale.

## **Neni 13**

### **Bashkëpunimi**

Bashkëpunimi është kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje midis tyre, nga një grup i organizuar, nga një bandë e armatosur ose nga një organizatë kundërrevolucionare.

## **Neni 14**

### **Bashkëpunëtorët**

Bashkëpunëtorë quhen organizatorët, ekzekutuesit, shfrytëzuesit dhe ndihmësit.

Organizatorë quhen personat që organizojnë, drejtojnë, përgatitin planin ose udhëheqin organizatën për kryerjen e

krimeve.

Ekzekutues quhen personat që marrin pjesë drejtpërsëdrejti për kryerjen e veprës penale.

Shtytës quhen personat që kanë shtyrë tjetrin për kryerjen e veprës penale.

Ndihmës quhen personat që japin ndihmë përkryerjen e veprës penale me këshilla, udhëzime, dhënie mjetesh dhe largim pengesash ose duke premtuar më parë fshehjen e personit që ka kryer veprën penale, të gjurmëve të saj ose të sendeve që rrjedhin nga ajo.

## **Neni 15**

### **Përgjegjësia e bashkëpunëtorëve**

Organizatorët, shtytësit dhe ndihmësit për veprën e kryer kanë përgjegjësi penale njëllor si ekzekutuesit.

Në caktimin e dënimit për bashkëpunëtorët gjykata duhet të marrë parasysh shkallën e pjesëmarrjes dhe rolin e luajtur secili në kryerjen e veprës.

Pjesëmarrësi i grupit të organizaur, ibandës së armatosur dhe i organizatës kundërrevolucionare përgjigjet jo vetëm për veprat penale, në të cilat ai ka marrë pjesë drejtpërsëdrejti, por edhe për ato që kryhen nga pjesëmarrës të tjerë, në qoftë se kryerja e këtyre veprave penale hynte në planin e veprimtrisë së tyre.

Shtytësit dhe ndihmësit përgjigjen për përgatitje sipas nenit 11 të këtij kodi, edhe në qoftë se personi, të cilin e kanë shtyrë për kryerjen e krimit ose të cilit i kanë dhënë ndihmën, nuk e kryen atë.

## **KREU I TRETË**

### **DËNIMET, MASAT MJEKËSORE DHE EDUKUESE**

## **Neni 16**

### **Kufizimi dhe qëlimi i dënimit**

Dënimi penal është një mjet shtrëngimi me karakter politik e ideologjik i shtetit socialist në luftën e kalsave.

Dënimi penal është armë e fuqishme e diktaturës së proletariatit në luftën kundër armiqve të saj, për mbrojtjen dhe forcimin e rendit shoqëror socialist.

Dënimi penal ka për qëllim ndalimin e veprimtarisë së mëtejshme keqbërëse të fajtorit, si edhe edukimin e tij për t'u bërë i dobishëm për shoqërinë.

Dënimi penal ka për qëllim, gjithashtu, të ndikojë për edukimin e shtetasve të tjerë me frymën e respektimit të ligjshmërisë socialiste.

## **Neni 17**

### **Llojet e dënimeve**

Kundër personave që kanë kryer krime nga gjykata jepen këto dënime kryesore:

1. Riedukim nëpërmjet punës.
2. Heqjen e lirisë.
3. Me vdekje.

Kundër personave që kanë kryer kundërvajtje penale nga gjykata jepen këto dënime kryesore:

1. Qortim shoqëror.
2. Gjobë.
3. Riedukim nëpërmjet punës.
4. Heqje e lirisë.

Kundër personave që kanë kryer vepra penale nga gjykata mund të jepen edhe këto dënime plotësuese.

1. Heqja e dekoratave.
2. Ndalim i ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie të caktuar.
3. Heqje e së drejtës së zgjedhjes.
4. Dëbim.
5. Internim.



## **Neni 18**

### **Qortimi shoqëror**

Qortimi shoqëror është qortimi që i jepet fajtorit nga ana e gjykatës në qendrën e punës ose të banimit.

## **Neni 19**

### **Gjoba**

Gjoba është dënimi në të holla. Dënimi me gjobë caktohet brenda kufijve të parashikuar nga pjesa e posaçme e këtij kodi dhe jepet nga pesëdhjetë gjer në një mijë lekë.

Gjykata kur cakton gjobën, duhet të marrë parasysh, veç të tjerave, edhe kushtet vetjake e familjare të fajtorit.

Në qoftë se nuk paguhet gjoba, gjykata vendos zëvendësimin e saj me riedukim nëpërmjet punës, duke llogaritur pesë lekë për një ditë pune.

## **Neni 20**

### **Riedukimi nëpërmjet punës**

Riedukimi nëpërmjet punës është detyrimi i fajtorit të punojë për një kohë nga një muaj gjer në një vit në qendrën e punës që caktohet me vendim të gjykatës ose në vendet që caktojnë organet e ekzekutivit.

Të dënuarit me riedukim nëpërmjet punës, me vendim të gjykatës, i ndalet në dobi të shtetit, gjer një e katërta e shpërblimit për punën që bën.

Koha e vuajtjes së këtij dëmi ekonomik nuk llogaritet në afatin e vjetërsisë në punë dhe as në afatin e kryerjes së shërbimit ushtarak.

Koha e paaftësisë së përkohshme në punë nuk llogaritet në afatin e këtij dënimi.

Të dënuarit, gjatë kohës së vuajtjes së dënimit me riedukim nëpërmjet punës, nuk i jepen shtesat mbi pagën bazë dhe përfitime të tjera.

Riedukimi nëpërmjet punës nuk jepet kundër personave që janë të paaftë për punë. Kundër tyre caktohet një dënim më i butë.

Për të dënuarit ushtarakë mënyra e zbatimit të dënimit me riedukim nëpërmjet punës rregullohet me dispozita të veçanta.

Në rast se i dënuari me riedukim nëpërmjet punës shmanget pa arsye nga vuajtja e dënimit, me vendim të gjykatës, ky dënim zëvendësohet me heqje të lirisë, duke llogaritur tri ditë riedukim nëpërmjet punës të pavuajtur me një ditë heqje të lirisë.

## **Neni 21**

### **Heqja e lirisë**

Dënimi me heqje të lirisë jepet me vendim të gjykatës për një kohë nga një muaj gjer në njëzet e pesë vjet dhe vuhet në vendet e riedukimit nëpërmjet punës ose në burg.

Personi që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, dënohet jo më shumë se me gjysmën e dënimit me heqje të lirisë së parashikuar nga ligji penal për veprën, e kryer.

Të miturit dënimin me heqje të lirisë e vuajnë në vende të veçanta.

## **Neni 22**

### **Dënimi me vdekje**

Dënimi me vdekje është një dënim i jashtëzakonshëm që jepet vetëm për krimet veçanërisht të rrezikshme.

Dënimi me vdekje nuk jepet kundër personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, sie dhe kundër grave që në kohën e kryerjes së krimit ose të gjyqimit janë shtatzëna.

Nuk ekzekutohet dënimi me vdekje, i dhënë kundër një gruaje,

kur konstatohet se ajo është shtatzënë në kohën kur duhej të ekzekutohej vendimi. Ky dënim zëvendësohet nga gjykata me njëzet e pesë vjet heqje lirie.

### **Neni 23**

#### **Heqja e titujve të nderit dhe e dekortave**

Heqja e titujve të nderit dhe e dekortave vendoset detyrimisht, kur gjykata për një vepër penale jep dënimin me heqje të lirisë për një kohë jo më pak se dhjetë vjet.

Gjykata, gjithashtu mund të vendosë heqjen e titujve të nderit dhe të dekoratave, kur jep dënim me heqje të lirisë nga një gjer në dhjetë vjet, në qoftë se këtë e çmon të nevojshme për shkak të natyrës sëv eprës së kryer.

Kur gjykata vendos heqjen e titujve të nderit dhe të dekoratave që i janë dhënë të dënuarit nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, vendimi i saj, pasi të marrë formën e prerë, duhet t'i njoftohet Presidiumit të Kuvendit Popullor.

### **Neni 24**

#### **Ndalimi i ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtrie të caktuar**

Ndalimi i ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie të caktuar jepet për një kohë nga një gjer në pesë vjet, kur gjykata konstaton se i dënuari i ka shpërdoruar ato dhe çmon se nuk duhet t'i ushtrojë në të ardhmen.

### **Neni 25**

#### **Heqja e së drejtës së zgjedhjes**

Me heqjen e së drejtës së zgjedhjes i dënuari nuk ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në Kuvendin Popullor, nëkëshillat popullore dhe në gjykatat.

Heqja e së drejtës së zgjedhjes jepet për kryerjen e në krimi dhe për nmjë kohë nga një gjer në pesë vjet.

## **Neni 26**

### **Dëbimi**

Dëbimi është largimi i të dënuarit nga vendbanimi me ndalim ose jo të qëndrojë në një ose në disa vende të caktuara.

Dëbimi jepet për një vepër penale për një kohë nga një gjer në pesë vjet në rastet kur gjykata çmon se qëndrimi i fajtorit në vende të caktuara është shoqërisht i rrezikshëm.

Dëbimi kundër të huajve mund të jepet edhe me nxjerrjen e tyre jashtë kufijve të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Ekzekutimi i këtij dënimi bëhet nga organet e punëve të brendshme pas vuajtjes së dënimit kryesor.

## **Neni 27**

### **Internimi**

Internimi është detyrimi i të dënuarit për të qëndruar në një vend të caktuar për një kohë nga një gjer në pesë vjet.

Internimi jepet nga gjykata për kryerjen e një krimi, kur ajo çmon se lëvizja e të dënuarit në vende të ndryshme paraqet rrezikshmëri shoqërore.

Ekzekutimi i këtij dënimi bëhet nga organet e punëve të brendshme pas vuajtjes së dënimit kryesor.

## **Neni 28**

### **Masat mjekësore dhe edukuese**

Masat mjekësore jepet kundër personave të papërgjegjshëm, kur kjo shihet e nevojshme, ndërsa masat edukuese jepen nga gjykata, kur çmon se dënimet nuk janë të përshtatshme ose kundër personave, që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale.

Masat mjekësore janë:

1. Mjekimi i detyruar.
2. Veçimi në një institucion mjekësor.

Masat edukuese janë:

1. Vendosja e të miturit në një institucion edukimi.
2. Lënia e personit për edukim kolektivit ose organizatave shoqërore.

Kreu i katërt

Caktimi i dënimit

## **Neni 29**

### **Mënyra e caktimit të dënimit**

Gjykata, si organ i diktaturës së proletariatit, duke shprehur dhe mbrojtur interesat e klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse, në caktimin e masës së dënimit vlerëson shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të personit, shkallën e fajësisë, si edhe të gjitha rrethanat lehtësuese e rënduese.

Masa e dënimit caktohet sipas dispozitave tëkëtij kodi dhe brenda kufijve të parashikuar nga ligji.

## **Neni 30**

### **Rrethanat lehtësuese**

Rrethana lehtësuese janë sidomos:

- a) kryerja e veprës penale nën ndikimin e tronditjes psikike, shkaktuar nga provokimi ose veprime të tjera të padrjta të të dëmtuarit;
- b) kryerja e veprës penale në rrethana të rënda familjare ose vetjake;
- c) kryerja e veprës penale nën ndikimin e kanosjes ose të shtrëngimit;
- ç) kryerja e veprës penale nga gruaja shtatzënë;

- d) kryerja e veprës penale nën ndikimin e verpimeve ose të udhëzimeve të padrejta të eprorëve;
- dh) pendimi i thellë i fajtorit për veprën e kryer;
- e) paraqitja pas kryerjes së veprës penale;
- ë) zëvendësimi i dëmit.

### **Neni 31**

#### **Rrethanat rëduese**

Rrethana rëduese janë sidmos:

- a) kryerja e veprës penale nga një person që ka kryer më parë një vepër tjetër penale;
- b) kryerja e veprës penale në bashkëpunim;
- c) kryerja e veprës penale për shkaqe të dobta;
- ç) kryerja e veprës penale kundër fëmijve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen;
- d) kryerja e veprës penale nga një person që ka detyra të rëndësishme shtetërorë dhe shoqërore;
- dh) shkaktimi i pasojave të rënda nga vepra penale.

### **Neni 32**

#### **Zbutja e dënimit në kufijtë e parashikuar nga ligji**

Gjykata në raste të jashtëzakonshme, kur çmon se vepra praqet rrezikshmëri shoqërore të vogël dhe personaliteti i fajtorit është i tillë që edhe me një masë dënimi më të butë nga ajo e parashikuar nga ligji mund t'i arrihet qëllimit për riedukimin e tij, mund të caktojë një dënim nën minimumin ose një lloj dënimi më të butë nga ai i parashikuar nga dispozita përkatëse e pjesës së posaçme të këtij Kodi.

Kur janë rrethanat e paragrafit të parë të këtij neni, gjykata mund të japë dënimin nën kufijtë e parashikuar nga ligji edhe kur këtë e kërkon kolektivi punonjës i qendrës së punës të fajtorit ose një organizatë shoqërore.

## **Neni 33**

### **Përgjashtimi nga dënimi për mungesë rrezikshmërie shoqërore**

Nuk dënohet personi, kur vepra e tij, megjithëse në kohën e kryerjes së saj parashikohej si vepër penale, gjatë hetimit ose shqyrtimit gjyqësor të çështjes ka humbur karakterin shoqërisht të rrezikshëm për shkak të ndryshimit të rrethanave politiko-shoqërore, si edhe kur personi nuk paraqet më rrezikshmëri shoqërore.

## **Neni 34**

### **Përgjashtimi i tëmiturve nga dënimi**

Gjykata mund të përgjashtojë nga dënimi të miturit që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, në këto raste:

- a) kur, për shkaqe të arsyeshme, nuk ishte në gjendje të kuptonte plotësisht se vepra e tij ishte shoqërisht e rrezikshme;
- b) kur ka kryer një vepër penale me rëndësi të vogël duke u ndodhur në gjendje tronditjeje psikike, nën ndikimin e një tjetri ose në rrethanat e rastit;
- c) kur çmohet se masat edukuese ia arrijnë qëllimit për përmirësimin e tij.

## **Neni 35**

### **Caktimi i dënimit për personat që kanë kryer disa vepra penale**

Kur veprimet ose mosveprimet e kryera përmbajnë elementet e disa veprave penale, si edhe kur pesoni ka kryer disa vepra penale, si edhe kur personi ka kryer disa vepra penale, për të cilat nuk është dhënë akoma vendimi, gjykata më parë cakton dënimin për çdo vepër veç e veç dhe pastaj cakton një dënim të vetëm, i cili përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar.

Dënimi i shtuar nuk mund të kapërcejë shumën e përgjithshme të dënimeve të caktuara veç e veç, as kufirin më të lartë të parashikuar prej këtij kodi për llojin e dënimit të dhënë.

Gjykata, kur e çmon të arsyeshme, jep si dënim përfundimtar dënimin që ka caktuar, për veprën më të rëndë.

Përveç dënimit kryesor, gjykata ka të drejtë të shtojë një ose më shumë nga dënimet plotësuese të dhëna prej saj për çdo vepër penale të veçantë.

### **Neni 36**

Kur i dënuari, para vuajtjes së plotë të dënimit, dënohet për një vepër të kryer para dhënies së vendimit, zbatohen rregullat e nenit të mësipërm dhe pjesa e vuajtur e dënimit llogaritet në dënimin e ri.

Kur i dënuari, pas dhënies së vendimit, por para vuajtjes së plotë të dënimit, kryen një vepër penale të re, gjykata bën bashkimin e dënimit të ri me pjesën e mbetur të dënimit të mëparshëm, duke ndjekur rregullat e parashikuara nga neni i mësipërm.

### **Neni 37**

#### **Llogaritja e paraburgimit**

Koha e paraburgimit llogaritet në dënimin me heqje të lirisë, me riedukim nëpërmjet punës ose me gjobë.

Kur jepet dënimi me riedukim nëpërmjet punës, një ditë paraburgim llogaritet me tri ditë riedukim nëpërmjet punës dhe, kur jepet dënimi me gjobë, një ditë paraburgim llogaritet me pesëmbëdhjetë lekë.

### **Neni 38**

#### **Dënimi me kusht**

Në qoftë se gjykata çmon se shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe e të dënuarit është e tillë që nuk ka nevojë për



veçim ose për të vuajtur dënimin me riedukim nëpërmjet punës, ka të drejtë që dënimin ta japë me kusht. Në këtë rast gjykata urdhëron qëtë mos ekzekutohet dënimi, në qoftë se gjtë afatit të caktuar i dënuari nuk kryen një vepër penale tjetër po aq të rëndë ose më të rëndë se ajo e mëparshme. Ky afat nuk mund të jetë më pak se një vit ose më shumë se pesë vjet.

Kur janë rrethanat e paragrafit të parë të këtij neni, gjykata mund të japë dënimin me kusht edhe me kërkesën e organizatave shoqërore ose të kolektivave punonjëse dhe mund t'u besojë atyre edukimin e përmirësimit e fajtorit të dënuar me kusht.

Kur i dënuari me kusht, brenda afatit të provës, kryen në vepër tjetër po aq të rëndë ose më të rëndë se ajo e mëparshme, gjykata tërheq dënimin e dhënë me kusht dhe zbaton rregullat e bashkimit të dënimeve.

Kur gjykata ka dhënë një dënim plotësues, ky ekzekutohet pavarësisht nëse dënimi kryesor është dhënë me kusht përveçse kur gjykata vendos ndryshe.

## **Neni 39**

### **Lirimi para kohe me kusht**

Kur i dënuari me heqje të lirisë ose me riedukim nëpërmjet punës tregon me sjelljen dhe punën e tij se është përmirësuar dhe kur vepra e kryer nuk paraqet rrezikshmëri të theksuar shoqërore, mund të lirohet nga gjykata para kohe, me kusht.

## **Kreu i pesë**

### **Parashkrimi i ndjekjes penale**

## **Neni 40**

### **Parashkrimi i ndjekjes penale**

Nuk mund të bëhet ndjekje penale, kur nga dita e kryerjes së kundërvajtjes penale gjer në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar pesë vjet.

## **Neni 41**

Kur personi që ka kryer një kundërvajtje penale i fshihet hetimit ose gjykimit pas marrjes kundër tij të masave të sigurimit, afati i parashkrimit për kundërvajtjen e kryer më parë ndërpritet dhe afati i parashkrimit llogaritet nga data e kryerjes së veprës penale të re.

## **Neni 42**

### **Parashkrimi i vendimit të dënimit**

Vendimi i dënimit për kundërvajtje penale nuk ekzekutohet, kur nga dita që ka marrë formën e prerë kanë kaluar dhjetë vjet.

## **Kreu i gjashtë**

### **Kufijtë e veprimit të ligjit penal**

## **Neni 43**

### **Përgjegjësia penale për shtetasit e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë**

Shtetasit shqiptarë për veprat penale të kryera si brenda, ashtu dhe jashtë territorit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë kanë përgjegjësi sipas legjislacionit penal të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Shtetasit shqiptarë, që kanë vuajtur dënimin jashtë shtetit për njëv epër penale të kryer atje, kanë përgjegjësi penale në rast se vepra e kryer parashikohet edhe nga legjislacioni penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Në këtë rast ata mund të përjashtohen në Shqipëri nga vuajtja e dënimit për atë vepër penale ose gjykata mund të caktojë kundër tyre një dënim nën minimumin e parashikuar ose njëlloj dënimi më të butë.

## **Neni 44**

### **Përgjegjësia penale e shtetasve të huaj dhe e personave pa shtetësi**

Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi për veprat penale të kryera në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë kanë përgjegjësi penale sipas dispozitave të këtij Kodi.

Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi kanë, gjithashtu, përgjegjësi penale sipas dispozitave të këtij Kodi edhe në rastin kur, megjithëse krimet kundër shtetit i kanë kryer jashtë territorit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, pasojat e tyre janë shfaqur brenda territorit të saj.

Çështja e marrjes në përgjegjësi penale të shtetasve të huaj që gëzojnë paprekshmëri diplomatike dhe që kanë kryer vepra penale në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë zgjidhet kurdoherë në rrugë diplomatike.

## **Neni 45**

### **Kufijtë e veprimit të ligjit penal në kohë**

Cilësimi i veprës penale dhe dënimi i saj bëhet në bazë të ligjit penal që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së saj.

Ligji i ri, që nuk e dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese.

Personat, që janë duke vuajtur dënimin e dhënë në bazë të ligjit të vjetër, përjashtohen nga vuajtja e mëtejshme e dënimit, kur, sipas ligjit të ri, veprimi ose mosveprimi nuk përbën vepër penale.

## **Neni 46**

### **Dispozita të posaçme**

Dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi zbatohen edhe për veprat penale të parashikuara nga ligje të posaçme penale.

## **Pjesa e posaçme**

### **a) Krimet**

#### **Kreu i parë**

#### **Krime kundër shtetit**

#### **Neni 47**

#### **Tradhtia ndaj Atdheut**

Tradhtia ndaj Atdheut është krimi më i rëndë që mund të kryejë shtetasi i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Tradhti ndaj Atdheut quhet çdo vepër e kryer për të përmbysur shtetin e diktaturës së proletariatit, si dhe çdo vepër të drejtuar kundër pavarësisë kombëtare, fuqisë mbrojtëse dhe sigurimit të jashtëm të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, siç janë sidomos:

a) organizimi ose pjesëmarrja në kryengritje të armatosur për të përmbysur shtetin socialist dhe Partinë e Punës të Shqipërisë, si forcë e vetme politike udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë;

b) ushtrimi në emër të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë i sovranitetit të popullit dhe i çdo atributi të tij në kundërshtim me Kushtetutën;

c) Nënshkrimi ose pranimi në emër të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë i kapitullimit ose i pushtimit të vendit;

ç) veprimtaria që synon në tjetërsimin e territorit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë ose prekjen e kufijve të saj;

d) pranimi për vendosjen e bazave dhe të forcave ushtarake të huaja brenda territorit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;

dh) krijimi i shoqërive dhe i institucioneve të tjera ekonomike e financiare të huaja ose të përbashkëta me monopolet dhe me shtetet kapitaliste, borgjeze e revizioniste, si edhe marrja e kredive prej tyre;

e) shkelja e betimit ushtarak, si organizimi ose pjesëmarrja në një komplot ose puç ushtarak, dorëzimi i forcave ushtarake dhe i

mjeteve të luftimit armikut, shkatërrimi ose vënia e tyre jashtë përdorimit për ta ndihmuar atë;

ë) bashkëpunimi me armikun në kohë lufte në zonat e pushtuara përkohësisht prej tij;

f) vënia në shërbim të shteteve të huaja për veprimtari armiqësore kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;

g) spiunazhi, kryerja e porosive të tjera të agjunkturës së huaj, si edhe dorëzimi i shteteve të huaja i sekretit ushtarak ose i ndonjë sekreti tjetër;

gj) arratisja jashtë shtetit, si edhe rufizimi për t'u kthyer në Atdhe i personit që është dërguar me shërbim ose është lejuar përkohësisht të shkojë jashtë shtetit.

Tradhtia ndaj Atdheut dënohet me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

## **Neni 48**

### **Spiunazhi**

Mbledhja, vjedhja, ruajtja me qëllim dorëzimi ose dorëzimi i informatave politike, ushtarake dhe ekonomike shteteve të huaja ose agjentëve të tyre, e kryer nga shtetas të huaj ose persona pa shtetësi dënohen:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

## **Neni 49**

### **Provokimi i luftës ose i prerjes së marrëdhënieve diplomatike me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë**

Përgatitja ose përdorimi i dokumenteve false, tregimi i informatave të rreme ose veprime të tjera të këtij lloji për të provokuar luftë ose prerje të marrëdhënieve diplomatike me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë dënohen:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

## **Neni 50**

### **Veprat terroriste**

Vepra terroriste kundër përfaqësuesve të shtetit dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë ose kundër personave të tjerë për shkak të veprimtarisë së tyre shtetërore ose shoqërore dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

Po këto vepra, të kryera kundër përfaqësuesve të shteteve të huaja, dënohen:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

## **Neni 51**

### **Organizimi i bandave të armatosura ose pjesëmarrja në to**

Organizimi i bandave të armatosura ose pjesëmarrja në këto banda, që hyjnë në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë nga jashtë ose që formohen brenda vendit për të kryer krime kundër shtetit dënohen:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

## **Neni 52**

### **Diversioni**

Shkatërrimi ose dëmtimi me anë plasjeje, zjarri ose me mënyra të tjera i pasurisë socialiste, helmatimet, përhapja e sëmundjeve epidemike, epizotike për të dobësuar ose minuar pushtetin popullor dënohen:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

## **Neni 53**

### **Sabotimi**

Veprimi ose mosveprimi për të dobësuar ose minuar veprimtarinë

shtetërore dhe të partisë së Punës të Shqipërisë, ekonominë socialiste, organizimin dhe drejtimin shtetëror e shoqëror dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

## **Neni 54**

### **Gjenocidi**

Veprat e kreyra me qëllim për të shktërruar plotësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik dhe racioal, si: a) vrasja e anëtarëve të grupit; b) dëmtimi i rëndë trupor ose mendor i anëtarëve të grupit; c) vënia me qëllim e grupit të plotë ose të pjesëshëm; ç) masat që kanë për qëllim tëndalojnë lindjet në gjirin e grupit dhe d) transferimi me forcë i fëmijëve të grupit në një grup tjetër, dënohen:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

## **Neni 55**

### **Agjitacioni e propaganda kundër shtetit**

Agjitacioni e propaganda fashiste, antidemokratike, fetare, luftënxitëse, antisocialiste, si edhe përgatitja, përhapja ose ruajtja për përhapje e literaturës me përmbajtje të tillë për të dobësuar ose minuar shtetin e diktaturës së proletariatit, dënohet:

me heqje të lirisë nga tre gjer në dhjetë vjet.

Po këto verpa, kur janë kryer në kohë lufte ose kanë shkaktuar pasoja veçanërisht të rënda, dënohen:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

## **Neni 56**

### **Nxitja e urrejtjes ose e grindjeve midis kombësive dhe racave**

Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve racioale ose nacionale, si edhe përgatitja, përhapja ose ruajtja me qëllim përhapjeje e shkrimeve

me përmbajtje të tillë dënohet:  
me heqje të lirisë nga tre gjer në dhjetë vjet.

### **Neni 57**

#### **Krijimi i një organizate kundërrevolucionare ose pjesëmarrja në të**

Krijimi i një organizate me karakter fashist, antidemokratik dhe antisocialist ose pjesëmarrja në të për të kryer krime kundër shtetit dënohen:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

### **Neni 58**

#### **Veprimtaria armiqësore para Çlirimit**

Veprimtaria aktive kundër lëvizjes revolucionare, e zhvilluar gjatë ose para pushtimit nazifashist nga persona të ndodhur në vende me përgjegjësi në shtet ose nga persona të ndodhur me shërbime të fshehta ose në organizata tradhtarë dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

### **Neni 59**

#### **Përkrahja pas kryerjes së krimit**

Fshehja e personit që kryen një krim kundër shtetit, fshehja e gjurmëve ose e sendeve të rrjedhura nga ky krim dënohen:

me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet dhe në rrethana veçanërisht të rënda me vdekje.

### **Neni 60**

#### **Veprimtaria kundër lëvizjes revolucionare të klasës punëtore**

Në bazë të parimit të internacionalizmit proletar, krimet kundër



shtetit, të parashikuara nga legjislacioni penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, edhe kur drejtohen kundër shteteve të tjera socialiste, lëvizjes revolucioanre të klasës punëtore, luftës së popujve për liri e pavarësi, përhapim shoqëror e socializëm, dënohen si krime të kryera kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

## **Kreu i dytë**

### **Krime kundër pasurisë socialiste**

#### **Neni 61**

##### **Përvetësimi i pasurisë socialiste**

Përvetësimi i pasurisë socialiste dënohet:  
me heqje të lirisë nga katër gjer në shtatë vjet.

#### **Neni 62**

Përvetësimi i pasurisë socialiste, i kryer më shumë se një herë ose nga një grup i organizuar ose me përpjesëtime të mëdha, dënohet:  
me heqje të lirisë jo më pak se shtatë vjet ose me vdekje.

#### **Neni 63**

Përvetësimi i pasurisë socialiste, edhe në qoftë se është kryer më shumë se një herë ose nga një grup i organizuar, kur vlefata e pasurisë së përvetësuar është e vogël, dënohet:  
me heqje të lirisë gjer në katër vjet.

#### **Neni 64**

Përvetësimi i pasurisë socialiste me anën e zhveshjes së

makinerive, kur vlefta e sendit të përvetësuar është e vogël, edhe kur kryhet më shumë se një herë ose nga një grup i organizuar, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në katër vjet.

### **Neni 65**

#### **Grabitja**

Grabitja e pasurisë socialiste dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

### **Neni 66**

#### **Blerja e pasurisë socialiste që rrjedh nga një krim ose pranimi i saj**

Blerja e pasurisë socialiste, që dihet se rrjedh nga një krim, ose pranimi i saj dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

Po kjo vepër, e kryer më shumë se një herë dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

### **Neni 67**

#### **Shkatërrimi ose dëmtimi i pasurisë socialiste me dashje**

Shkatërrimi ose dëmtimi i pasurisë socialiste me dashje dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, e kryer me zjarr ose me mjet tjetër të rrezikut të përbashkët ose kur ka shkaktuar pasoja të rënda, dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet ose me vdekje.

### **Neni 68**

## **Shkatërrimi ose dëmtimii pasurisë socialiste nga pakujdesia**

Shkatërrimi ose dëmtimi i pasurisë socialiste nga pakujdesia me anë zjarri ose me mjet tjetër të rrezikut të përbahskët, kur ka shkaktuar pasoja të rënda, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

### **Kreu i tretë**

#### **Krime kundër sistemit socialist të ekonomisë**

1. Krime në fushën e industrisë, të ndërtimit dhe të bujqësisë

#### **Neni 69**

##### **Nxjerrja e prodhimit me cilësi jo të mirë**

Nxjerrja e prodhimit industrial ose ndërtimi i veprave të rëndësishme me cilësi jo të mirë ose jo të plotë ose në kundërsthim me standardet ose projektet nga drejtori, kryeinxhinieri dhe, në mungesë të tij, nga inxhinieri përgjegjës dhe shefi i kontrollit teknik të ndërmarrjes ose nga personat e tjerë të ngarkuar me kontrollin e cilësisë dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

#### **Neni 70**

##### **Përdorimi ose ruajtja e pakujdesshme e makinerive dhe e pajisjeve teknike**

Përdorimi ose ruajtja e pakujdesshme emakinerive dhe e pajisjeve teknike industriale, bujqësore ose të ndërtimit, kur janë shkaktuar pasoja të rënda, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në shtatë vjet.

## **Neni 71**

### **Dëmtimi i veprave ujitëse dhe kulluese**

Dëmtimi me dashje i kanaleve ujitëse dhe kulluese ose i ndërtimeve të lidhura me to, si edhe i rezervuarëve, pompave ose pendave të lumenjve, kur kjo vepër janë shkaktuar pasoja të rënda, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në shtatë vjet.

## **2. Krime në fushën e trgtisë**

## **Neni 72**

### **Kontrabanda**

Kontrabanda dënohet:

me riedukim nëpërmjt punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër, e kryer me përpjesëtime të mëdha ose nga një grup i organizuar, dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet.

## **Neni 73**

### **Ushtrimi i tregtisë së ndaluar**

Blerja për shitje, si edhe rishitja e mallrave dhe e sendeve të tjera me qëllim fitimi në përpjesëtime të mëdha dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

## **Neni 74**

### **Mashtrimi në peshë dhe në matje**

Mashtrimi i blerësve në peshë ose në matje me qëllim fitimi dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në shtatë vjet.

### **Neni 75**

#### **Shitja e mallrave me çmim më të lartë**

Shitja e mallrave me çmime më të larta nga ato që janë caktuar prej organit kompetent ose shitja e mallrave të një cilësie më të dobët me çmimet e caktuara për një cilësi më të lartë dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në shtatë vjet.

3.Krime në fushën e financave

### **Neni 76**

#### **Falsifikimi i monedhave**

Falsifikimi i monedhave shtetërore, i letrave me vleftë të shtetit dhe i valutës së huaj ose vënia në qarkullim e tyre dënohet:

me heqje të lirisë nga një gjer në pesë vjet.

Kur veprat e mësipërme kryhen nga një grup i organizuar ose në përpjesëtime të mëdha, dënohen:

me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet ose me vdekje.

### **Neni 77**

#### **Shkelja e dispozitave mbi valutën dhe arin**

Shkelja e dispozitave në lidhje me veprimet e valutës, të arit, platinit, argjendit, si edhe shkrirja në shufra e monedhave ose përdorimi i tyre për të bërë sende të ndryshme, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë

vjet.

#### 4. Krime në fushën e transportit

##### **Neni 78**

#### **Shkatërrimi ose dëmtimi me dashje i rrugëve dhe i mjeteve të komunikacionit**

Shkatërrimi ose dëmtimi me dashje i rrugëve të komunikacionit, i veprave që lidhen me to, i shenjave rrugore, i mjeteve të komunikacionit dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

Po këto vepra, kur kanë shkaktuar përplasje, përmbysje, avari, vdekje ose pasoja të tjera të rënda, dënohen:

me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet ose me vdekje.

##### **Neni 79**

#### **Dëmtimi nga pakujdesia i rrugëve dhe i mjeteve të komunikacionit**

Dëmtimi nga pakujdesia i rrugëve dhe i mjeteve të komunikacionit, i veprave që lidhen me to dhe i shenjave rrugore, kur nga këto vepra janë shkaktuar përplasje, përmbysje, avari, vdekje ose pasoja të tjera të rënda, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

##### **Neni 80**

#### **Shkelja e disiplinës së punës në transport**

Shkelja e disiplinës së punës prej punonjësve të transportit hekurudhor, ujor dhe ajror, në qoftë se kjo shkelje ka sjellë ndërprerjen e planeve të transportit, dëmtimin e rrugëve, të

ndërtimeve ose të mjeteve të transportit, ndonjë çrregullim tjetër të rëndësishëm në punën e transportit, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur ka sjellë përmbysje, përplasje, avari ose ka shkaktuar vdekje ose pasoja të tjera të rënda, dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet.

## **Neni 81**

### **Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor**

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen, plagosjen e rëndë të një personi, plagosjen e lehtë të disa personave ose pasoja të tjera të rënda dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar vdekje ose plagosje të rëndë të personave, dënohet.

me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet.

## **Neni 82**

### **Dëmtimi i kablove dhe i linjave**

Dëmtimi i kablove, i linjave elektrike, telegrafike, telefonike ose i pajisjeve të lidhura me to, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

## **Kreu u katërt**

### **Krime kundër personit dhe familjes**

#### **1.Krime kundër jetës**

## **Neni 83**

### **Vrasja**

Vrasja me dashje dënohet:  
me heqje të lirisë nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

## **Neni 84**

Vrasja me dashje e kryer:

- a) për interes, për hakmarrje, për xhelozë ose për shkaqe të tjera të dobëta;
- b) kundër dy ose më shumë personave ose më shumë se një herë;
- c) kundër një personi që nuk mund të mbrohet;
- ç) në mënyrë që i shkakton mundime të veçanta viktimës;
- d) në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave;
- dh) nga një person që kishte për detyrë të kujdesej veçanërisht për viktimën;
- e) kundër një gruaje, duke e ditur që është shtatzënë, dënohet:  
me heqje të lirisë jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me vdekje.

## **Neni 85**

Vrasja me dashje, e kryer në gjendje tronditjeje të fortë psikike të çastit, shkaktuar nga dhuna ose fyerja e rëndë nga ana e të dëmtuarit, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në tetë vjet.

## **Neni 86**

Vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme



dënohet:

me heqje të lirisë gjer në te vjet.

### **Neni 87**

Vrasja e foshnjës, e kryer me dashje nga ana e nënës gjatë lindjes ose menjëherë pas lindjes, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në tre vjete.

### **Neni 88**

Vrasja e kryer nga pakujdesia dënohet:

me heqje të lirisë gjer në tetë vjet.

### **Neni 89**

#### **Shkaktimi i vetëvrasjes**

Shkaktimi i vetëvrasjes ose i tentativës së vetëvrasjes së një personi nga trajtimi i keq sistematik ose nga sjellje të tjera sistematike që ulin rëndë dinjitetin njerëzor dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

## **2. Krime kundër shëndetit**

### **Plagosja**

### **Neni 90**

#### **Plagosja e rëndë**

Plagosje me dashje, që është e rrezikshme oper jetën në çastin e shkaktimit ose që ka sjellë humbjen e shikimit, të dëgjimit ose të funksionit të një organi tjetër, ndërprerjen e shtatzanisë, shëmtimin e përhershëm të fytyrës, sëmundje psikike dhe çdo

tronditje tjetër të shëndetit që ka pasur si pasojë humbjen e përhershme të aftësisë për punë në mbi një të tretën dënohet:  
me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër e kryer kundër disa personave ose më shumë se një herë, si edhe kur ka sjellë si pasojë vdekjen, dënohet:  
me heqje të lirisë nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

### **Neni 91**

Plagosja e rëndë me dashje e kryer në gjendje tronditjeje të fortë psikike të çastit shkaktuar nga dhuna ose fyerja e rëndë nga ana e të dëmtuarit, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

### **Neni 92**

Plagosja e rëndë me dashje, e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

### **Neni 93**

#### **Plagosja e lehtë**

Plagosja e lehtë me dashje dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

Po kjo vepër, e kryer më shumë se një herë ose kundër disa personave dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

### **Neni 94**

#### **Heqja e paligjshme e lirisë**

Heqja e paligjshme e lirisë nëdëm të dias personave ose kur vë në rrezik dhe shëndetim e personit ose shkakton vuajtje fizike dënohet:

me heqjen e lirisë gjer në pesë vjet.

### **Neni 95**

#### **Dështimi i palejuar**

Dështimi i palejuar më shumëse një herë ose që ka sjellë si pasojë vdekjen ose tronditjen e rëndë të shëndetit të gruas dënohet:

me heqje të lirisë gjer në tetë vjet.

### **Neni 96**

#### **Mjekimi i pakujdesshëm**

Mjekimi i pakujdesshëm i të sëmurëve nga ana e mjekut ose e personelit tjetër mjekësor, si edhe moszbatimi i terapisë ose i personave të mjekut nga personeli mjekësor ose farmacist, kur këto vepra kanë shkaktuar dëmtimin e rëndë të shëndetit, kanë rrezikur jetën e personit ose kanë shkaktuar vdekjen e tij, dënohen:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

### **3. Krime seksuale**

### **Neni 97**

#### **Marrëdhënie seksuale me dhunë.**

Marrëdhënie seksuale, të kryera me dhunë ose duke përfituar nga pazotësia e së dëmtuarës për t'u mbrojtur, dënohen:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

Po këto vepra, të kreyra në bashkëpunim, si edhe kur kanë shkaktur pasoja të rënda për shëndetin, dënohen:

me heqje të lirisë jo në pak se dhjetë vjet dhe, kur kanë sjellë si pasojë vetëvrasjen ose vdekjen e së dëmtuarës, edhe me vdekje.

## **Neni 98**

### **Marrëdhënie seksuale me të miturat**

Marrëdhëniet seksuale me një vajzë që nuk arritur moshën katërbëdhjetë vjeç ose pjekurinë seksuale dënohen:

me heqje të lirisë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Po këto vepra të kryera me dhunë, në bashkëpunim ose kur kanë shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin dënohen:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet dhe, kur kanë sjellë si pasojë vetëvrasjen ose vdekjen e së dëmtuarës, edhe me vdekje.

## **Neni 99**

### **Vepra të turpshme**

Kryerja e veprave të turpshme me persona që nuk kanë arritur moshën katërbëdhjetë vjeç dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

## **Neni 100**

### **Marrëdhënie seksuale në gjini**

Marrëdhëniet seksuale midis personave që janë gjini në vijë të drejtë ose midis vëllait e motrës dënohen:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

**Kreu i pestë**  
**Krime kundër pasurisë së shtetasve**  
**Neni 101**  
**Vjedhja**

Vjedhja e pasurisë së tjetrit dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër, e kryer më shumë se një herë ose nga një grup i organizuar ose në përpjesëtime të mëdha, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

**Neni 102**  
**Grabitja**

Sulmi për të vënë në dorë pasurinë e tjetrit, që bëhet me dhunë fizike ose me kanosje se do të përdoret dhunë fizike aty për aty, dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet ose me vdekje.

**Neni 103**  
**Shtrëngimi**

Detyrimi i një personi që të japë pasuri ose përfitime të tjera pasurore, me kanosje se do të përdoret dhunë fizike kundër tij ose të afërmeve të tij ose do t'i shkaktohet një dëm i rëndësishëm pasuror ose do të zbulohen fakte poshtëruese për të ose për të afërmit e tij dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

**Neni 104**  
**Mashtrimi**

Përvetësimi i pasurisë së tjetrit ose i përfitimeve të tjera pasurore me anë të gënjeshtërs ose me anë të shpërdorimit të besimi dënohet:

me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

Po kjo veprë, e kryer më shumë se një herë, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

## **Neni 105**

### **Kreu i gjashtë**

#### **Krime në ushtrimin e detyrës**

## **Neni 106**

### **Shpërdorimi i detyrës**

Kryerja me dashje e veprave që janë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës shtetërore a shoqërore ose moskryerja me dashje e detyrës, kur kanë sjellë ose dihej se mund t'u sillnin pasoja të rënda interesave shtetërore, shoqërore ose të drejtave, dhe interesave të ligjshme të shtetasve, dënohet: me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

## **Neni 107**

### **Shkelja e barazisë së shtetasve**

Krijimi i privilegjeve, i pabarazisë kombëtare, si edhe çdo veprim tjetër që shkel të drejtat e pakicave kombëtare, kur vepra nuk përbën krim kundër shtetit, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

## **Neni 108**

### **Qendrimi i pakujdesshën në detyrë**

Qendrimi i pakujdesshëm në përmbushjen e detyrës shtetërore ose shoqërore, kur u ka sjellë pasoja të rënda interesave shtetërore, shoqërore ose të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

## **Neni 109**

### **Mita**

Marrja e mitës në sajë të detyrës dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

Dhënia e mitës dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

## **Neni 110**

### **Falsfikimi**

Paraqitja në dokumentet zyrtare e rrethanave ose e të dhënave që dihet se janë të rreme, përpilimi ose dhënia e dokumenteve që dihet se janë false, si edhe falsifikimi i dokumenteve të shtetasve që ndodhen në dosjen e një institucioni, ndërmarrjeje ose organizate edhe në qoftë se është kryer më shumë se një herë dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në tetë vjet.

## **Kreu i shtatë**

### **Krime kundër drejtësisë**

## **Neni 111**

## **Përkrahja pas kryerjes së krimit**

Fshehja e personit që kryen krim, fshehja e gjurmëve ose e sendeve të rrjedhura nga një krim, kur për këtë krim parashikohet dënim me heqje të lirisë më tepër se dy vjet, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër, në lidhje me një krim për të cilin parashikohet dënim me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

### **Neni 112**

#### **Moskallzimi i krimit**

Moskallzimi i një krimi, të parashikuar nga nenet 62, 65, 67 paragrafi i dytë, 72 paragrafi i dytë, 76 paragrafi i dytë, 83, 84 e 102 të këtij kodi, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

Moskallzimi i një krimi kundër shtetit, të parashikuar nga nenet 45-47 dhe 60 të këtij kodim që dihet me siguri se përgatitet ose është kryer, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

### **Neni 113**

#### **Kallëzimi i rremë**

Kallëzimi për kryerjen e një krimi që dihet se nuk është kryer ose për kryerjen e një krimi nga një person që dihet se nuk e ka kryer atë, si edhe krijimi i provave të rreme, i bërë me qëllim që të fillojë procedimi penal dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

### **Neni 114**



## **Fillimi i paligjshëm i procedimit penal**

Fillimii procedimit penal nga ana e organeve të hetimit, të prokurorisë ose të gjykatës kundër një personi, që dihet se është i pafajshëm, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

### **Neni 115**

#### **Shtrëngimi për të bërë deklaratat**

Përdorimi i dhunës për të bërë deklaratat nga ana e personit që zhvillon hetime dënohet:

me heqje të lirisë gjer në tetë vjet.

### **Neni 116**

#### **Dhënia e një vendimi të padrejtë**

Dhënia e një vendimi gjyqësor përfundimtar, që dihet se është i padrejtë, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

### **Neni 117**

#### **Largimi i të arrestuarit ose i të dënuarit**

Largimi i të arrestuarit a i të dënuarit me heqje të lirisë ose i të internuarit nga vendi i qëndrimit të detyrueshëm a gjatë udhëtimit dënohet:

me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

### **Kreu i tetë**

#### **Krime kundër rendit administrativ**

## 1. Krime kundër veprimtarisë shtetërore ose shoqërore

### **Neni 118**

#### **Kundërshtimi ndaj përfaqësuesit të shtetit**

Kundërshtimi me dhunë fizike ose në bashkëpunim që i bëhet përfaqësuesit të shtetit, kur është duke kryer detyrën sipas ligjit dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

### **Neni 119**

#### **Goditjet për shkak të detyrës**

Goditjet ose vepra të tjera dhune që i bëhen një personi për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore, shoqërore ose në prodhim, dënphen:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

### **Neni 120**

#### **Fyerja e personit për shkak të detyrës**

Fyerja e personit për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore a shoqërore ose në prodhim, e kryer botërisht në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

### **Neni 121**

#### **Falsfikimi i dokumenteve ose vënia në dorë e tyre me qëllim përdorimi**

Përvetësimi, shitja, falsifikimi ose vënia në dorë me qëllim përdorimi e dokumenteve zyrtare ose përdorimi i dokumenteve të tilla që i përkasin një tjetri, edhe në qoftë se është kryer më shumë se një herë dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

2. Krime në lidhje me mbrojtjen e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë

### **Neni 122**

#### **Përhapja e sekretit shtetëror**

Përhapja e informatave që përbëjnë sekret shtetëror nga persona të cilëve u janë besuar këto informata ose që, për shkak të detyrës, kanë mundur t'i marrin këto informata dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

### **Neni 123**

#### **Humbja e dokumenteve**

Humbja nga personat, të cilëve u kanë besuar, e dokumenteve, e botimeve ose e materialeve të tjera, që përbëjnë sekret shtetëror, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

### **Neni 124**

#### **Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik**

Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër, e kryer në kohë lufte ose gjendjeje të

jashtëzakonshme, dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

### **Neni 125**

#### **Shmangia nga detyrimet e mbrojtjes civile**

Moskryerja në kohë lufte ose gjendjeje të jashtëzakonshme e detyrimeve në radhët e reparteve të mbrojtjes civile të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

### **Neni 126**

#### **Shpallja jashtë shtetit e shpikjeve ose e racionalizimeve**

Shpallja ose dhënia jashtë shtetit e shpikjeve ose e racionalizimeve që përbëjnë sekret shtetëror, të cilat janë bërë në Shqipëri ose jashtë shtetit dënohen:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

3. Krime në lidhje me ruajtjen e kufijve shtetërore

### **Neni 127**

#### **Kalimi i paligjshëm i kufijve**

Kalimi i paligjshëm i kufijve të shtetit dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

### **Neni 128**

#### **Shkelja e rregullave mbi fluturimet**

Shkelja e rregullave mbi fluturimet ndërkombëtare, veçanërisht

hyrja në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë ose dalja prej saj pa leje fluturimi, mosrespektimi i vijave të fluturimit, i vendeve të zbritjes, i korridoreve ajrore, i lartësisë së fluturimit të caktuar, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

#### 4. Krime kundër sigurimit shoqëror

##### **Neni 129**

##### **Sjellja e padenjë në shoqëri**

Sjellja e padenjë në shoqëri për motive rrugaçërie, që cenon në mënyrë të dukshme rregullat e bashkëjetesës socialiste, dënohet: me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

##### **Neni 130**

##### **Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë**

Shkelja e rregullave të teknikës së sigurimit, të higjienës ose të rregullave të tjera të mbrojtjes në punë, në qoftë se kjo shkelje ka shkaktuar vdekje ose pasoja të tjera të rënda, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

##### **Neni 131**

##### **Shkelja e rendit teknik në prodhim**

Shkelja e rregullave teknike, e disiplinës teknike të prodhimit ose e kushteve të punës, që sigurojnë punonjësin në prodhim, kur nga këto është shkaktuar vdekje ose pasoja të tjera të rënda dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

## **Neni 132**

### **Shkelja e rregullave në kryerjen e punimeve**

Shkelja e rregullave të ndërtimit, të higjienës ose kundër zjarrit, të caktuara për punimet e ndërtimit ose për sigurimin në miniera, në qoftë se kjo shkelje ka shkaktuar vdekje ose pasoja të tjera të rënda, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

## **Neni 133**

### **Shkelja e rregullit në prodhim**

Pirja e duhanit, paraqitja në gjendje të dehur ose fjetja gjatë prodhimit në repartet ku ka rrezik plasjeje, kur kanë shkaktuar vdekje ose pasoja të tjera të rënda, dënohen:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

## **Neni 134**

### **Përgatitja ose shtja e lëndëve narkotike dhe helmuese**

Përgatitja, mbajtja dhe shitja e lëndëve helmuese me efekt të fortë pa leje dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

Përgatitja, mbajtja dhe shitja e lëndëve narkotike pa leje dënohet: me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjerë në dhjetë vjet.

5. Krime kundër moralit shoqëror

## **Neni 135**

Ushtrimi kurvërisë, shtytja ose ndërmjetësimi për kurvëri, si edhe dhënia e shpërblimit, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

## **Neni 136**

### **Pornografia**

Prodhimi, shpërndarja dhe reklamimi i veprave, i botimeve, i figurave dhe i sendeve të tjera pornografike, si edhe tregtimi i tyre ose mbajtja e tyre me qëllim shitjeje ose shpërndarjeje, dënohen:

me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

## **Neni 137**

### **Pederastia**

Pederastia dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

## **Kreu i nëntë**

### **Krime ushtarake**

## **Neni 138**

### **Personat që kanë përgjegjësi penale për kryerjen e krimeve ushtarake**

Për krime ushtarake kanë përgjegjësi penale ushtarakët e shërbimit aktiv, të detyruarit ushtarake, të thirrurit për stërvitje, si edhe personat e tjerë me ligj barazohen me ta.

## **Neni 139**

### **Shmangia nga shërbimi ushtarak**

Shmangia përgjithnonë nga shërbimi ushtarak dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër, e kryer në kohë lufte ose gjendjeje të jashtëzakonshme, dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet ose me vdekje.

## **Neni 140**

### **Largimi pa leje**

Largimi pa leje i ushtarëve dhe i nënoficerëve të shërbimit të detyruar ushtarak nga reparti ose vendi i shërbimit për një kohë më tepër se 24 orë ose më shumë se një herë për një kohë edhe më pak se 24 orë, i kryer në kohë lufte ose gjendjeje të jashtëzakonshme, dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se tre vjet.

Po kjo vepër, e kryer nga oficerët dhe nënoficerët e shërbimit aktiv për një kohë më tepër se tri ditë ose më shumë se një herë për një kohë edhe më pak se tre ditë, dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet.

## **Neni 141**

### **Mosparaqitja në repart ose në vendin e shërbimit**

Mosparaqitja e ushtarëve dhe e nënoficerëve të shërbimit aktiv, pa shkaqe të arsyeshme në repart ose në vendin e shërbimit, për një kohë më tepër se 24 orë, ose më shumë se një herë për një kohë edhe më pak se 24 orë, e kryer në kohë lufte ose gjendjeje të jashtëzakonshme, dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se dy vjet.



## **Nei 142**

### **Moszbatimi i urdhrit**

Moszbatimii një urdhërshërbimi, i kryer në bashkëpunim ose prej një personi të kuadrit komandues, ose kur ka shkaktuar pasoja të rënda, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, e kryer në kohë lufte ose gjendjeje të jashtëzakonshme, dënohet me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet ose me vdekje.

## **Neni 143**

### **Shmangia e përkohshme nga shërbimi**

Shmangia e përkohshme nga shërbimi ushtarak ose nga kryerja e detyrave të shërbimit ushtarak, duke dëmtuar shëndetin, duke u shtirë i sëmurë, duke falsifikuar dokumente ose me ndonjë mënyrë tjetër, e kryer në kohë lufte ose gjendjeje jashtëzakonshme, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

## **Neni 144**

### **Kundërshtimi dhe shtrëngimi për të shkelur detyrën**

Kundërshtimi që i bëhet një ushtaraku në kryerjen e detyrave të shërbimit ushtarak ose shtrëngimi i këtij për t'i shkelur këto detyra dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

Po këto vepra, të kryera në kohë lufte ose gjendjeje të jashtëzakonshme dënohen:

me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet ose me vdekje.

## **Neni 145**

### **Moscaktimi i rojave**

Moscaktimi ose mosnxjerrja e rojave dhe e personave për shoqërim pa shkaqe të arsyeshme në kohë lufte ose gjendjeje të jashtëzakonshme, kur kanë shkaktuar pasoja të rënda, dënohen: me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

## **Neni 146**

### **Shkelja e rregullave të shërbimit të rojës**

Shkelja e rregullave të shërbimit të rojës ose të shërbimit të shoqërimit nga personat e ngarkuar për të kryer këto shërbime në objekte që kanë një rëndësi veçanërisht të madhe shtetërore, ose në ruajtje të kufijve të shtetit, kur janë kryer në kohë lufte ose gjendjeje të jashtëzakonshme ose kur kanë shkaktuar pasoja të rënda, dënohen: me heqje të lirisë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

## **Neni 147**

### **Shpërdorimi, shkatërimi ose dëmtimi i pasurisë ushtarake**

Shpërdorimi, shkatërimi ose dëmtimi me dashje i armatimeve, i mjeteve të komunikacionit ose të ndërlidhjes dhe të teknikës luftarake, të dhëna në përdorim ose në ruajtje, dënohen: me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

Po këto vepra, të kryera me zjarr a me mjet tjetër të rrezikut të përbashkët, ose kur kanë shkaktuar vdekje a pasoja të rënda, ose në kohë lufte a gjendjeje të jashtëzakonshme, dënohen: me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet ose me vdekje.

## **Neni 148**

## **Shkatërrimi i pasurisë ushtarake nga pakujdesia**

Shkatërrimi nga pakujdesia e armatimeve, i teknikës luftarake ose i mjeteve të komunikacionit dhe të ndërlidhjes, të dhëna në ruajtje ose në përdorim, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

Po këto vepra, kur kanë shkaktuar vdekje ose pasoja të tjera të rënda ose janë kryer në kohë lufte a gjendjeje të jashtëzakonshme dënohen:

me heqje të lirisë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

### **Neni 149**

#### **Shkelja e rregullave të fluturimeve ajrore**

Shkelja e rregullave të fluturimit dhe të përgatitjes së teknikës së fluturimit, kur nga këto janë shkaktuar vdekje ose pasoja të tjera të rënda, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

### **Neni 150**

#### **Shkelja e rregullave të lundrimit të anijeve**

Shkelja e rregullave të lundrimit të anijeve dhe të përgatitjes së teknikës së lundrimit, kur nga këto vepra janë shkaktuar vdekje ose pasoja të tjera të rënda, dënohen:

me heqje të lirisë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

### **Neni 151**

#### **Shkelja e rregullave të drejtimit dhe të shfrytëzimit të makinave luftarake**

Shkelja e rregullave të drejtimit dhe të shfrytëzimit të makinave

luftarake, kur nga këto vepra janë shkaktuar vdekje ose pasoja të rënda, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

## **Neni 152**

### **Shkatërrimi i mjeteve të luftimit**

Shkatërrimi ose vënia jashtë përdorimit nga ana e kuadrit komandues, kundër rregullave ushtarake e fortifikatave, anijeve, tankeve, aeroplanëve, depove ushtarake dhe e mjeteve të tjera të luftimit që i janë besuar, mosmarrja e masave të duhura për shkatërrimin ose vënien jashtë përdorimit të mjeteve të mësipërme të luftimit, kur ato rrezikohen të bien menjëherë në duart e armikut dhe kur nuk janë përdorur të gjitha mundësitë dhe mënyrat për shpëtimin e tyre, dënohet:

me heqje të lirisë nga pesë gjer në njëzet vjet dhe, kur ka shkaktuar pasoja të rënda, me heqje të lirisë jo më pak se njëzet vjet ose me vdekje.

## **Neni 153**

### **Shmangia nga urdhrat për luftim**

Shmangia me dashje e kuadrit komandues nga urdhrat që janë dhënë për luftim, e kryer jo me qëllim favorizimi të armikut, por në kundërshtim me rregullat ushtarake, dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se tre vjet dhe, kur ka pasoja veçanërisht të rënda, edhe me vdekje.

## **Neni 154**

### **Largimi nga fusha e betejës dhe dorëzimi rob**

Largimi pa urdhër nga fusha e betejës në kohë luftimi ose refuzimi për të vepruar për të vepruar me armë në kohë luftimi, si edhe dorëzimi rob për shkak frike ose dobësie, dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet ose me vdekje.

### **Neni 155**

#### **Humbja e flamurit**

Humbja e flamurit të njësisë ushtarake në luftë për shkak të frikës dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

### **Neni 156**

#### **Braktisja e një anijeje lufte në mbytje e sipër**

Braktisja e një anijeje lufte, që është në mbytje e sipër, nga ana e kuadrit komandues, që nuk ka kryer gjer nëfund detyrat e veta të shërbimit, si edhe nga ana e personave të ekuipazhit të anijes, pa urdhrin përkatës të komandës eprorë dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

### **Neni 157**

#### **Përvetësimi i sendeve të të vrarëve, të të plagosurve dhe të robërve**

Përvetësimi në fushën e betejës i sendeve që gjendjen tek të vrarët dhe të plagosurit, si edhe plaçkitja e robërve të luftës dënohet:

me heqje të lirisë nga tre gjer në dhjetë vjet dhe, kur ka rrethana rënduese, me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

### **Neni 158**

#### **Braktisja e të plagosurve**

Braktisja e të plagosurve në fushën e betejës nga ana e personave

që janë të detyruar t'i tërheqin dënohet:  
me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

### **Neni 159**

#### **Dhuna kundër popullsisë në zonat e operacioneve ushtarake**

Dhuna mbi personin, përvetësimet, grabitja, shkatërrimi dhe marrja e paligjshme e pasurisë nën pretekstin e nevojës ushtarake në dëm të popullsisë që gjendet në zonat e operacioneve ushtarake dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, e kryer në rrethana rënduese dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

### **Neni 160**

#### **Sjellja e egër me robërit e luftës**

Sjellja e egër me robërit e luftës ose kryerja e pakujdesshme e detyrave kundrejt robërve të luftës të sëmurë ose të plagosur nga ana e personave të ngarkuar me mjekimin e tyre dënohet:

me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

#### **B. Kundërvajtjet penale**

#### **Kreu i parë**

#### **Kundërvajtje penale në fushën e ekonomisë**

### **Neni 161**

#### **Përvetësimi i pasurisë socialiste të gjetur**

Përvetësimi i pasurisë socialiste, të gjetur ose të rënë në dorë gabimisht ose rastësisht, dënohet:

me gjobë gjer në një mijë lejë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 162**

#### **Shkelja e dispozitave mbi tregtinë e jashtme**

Shkelja e dispozitave mbi monopolin e tregtisë së jashtme dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 163**

#### **Fshehja e sendeve që janë objekt kontrabande**

Fshehja, blerja ose shitja e sendeve që dihet se janë objekt kontrabande, kur kryhen më shumë se një herë, dënohen:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 164**

#### **Ushtrimi i tregëtisë së ndaluar**

Blerja për shitje, si edhe ushtrimi i çdo veprimtarie tjetër shitblerjeje të mallrave ose të sendeve me qëllim fitimi, dënohet:

me qortim shoqëror, me gjobë gjer në një mijë lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 165**

#### **Ushtrimi i profesionit pa leje**

Ushtrimi i zejes ose i profesionit pa leje, kur më parë personi është dënuar për kundërvajtje administrative, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës osse me heqje të lirisë gjer në një vit.

### **Neni 166**

#### **Falsfikimi i vulave të njërive të matjes**

Përgatitja ose ruajtja me qëllim shitjeje e vulave të falsifikuara të njërive të matjes, si edhe përdorimi i tyre dënohen:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 167**

#### **Shkelja e rregullave në ndërtim**

Shkelja e rregullave mbi projektimin, planifikimin, ndërtimin dhe financimin e investimeve dhe të ndërtimeve themelore, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 168**

#### **Dëmtimi i kablove dhe i linjave**

Dëmtimi i kablove, i linjave elektrike, telegrafike, telefonike ose i pajisjeve të lidhura me to dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 169**

#### **Pushtimi dhe shpërdorimi i tokës**

Pushtimi i tokës ose çdo shpërdorim i saj dënohet:

me gjobë gjer në pesëqind lekë, me riedukim nëpërmjet punës



ose me heqje të lirisë gjer në gjashtë muaj.

### **Neni 170**

#### **Shkelja e dispozitave mbi karantinën e bimëve**

Shkelja e dispozitave mbi karantinën e brendshme dhe të jashtme të bimëve, në qoftë se kjo shkelje ka shkaktuar pasoja të rënda, dënohet:

me qortim shoqëror, me gjobë gjer në një mijë lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

### **Neni 171**

#### **Shkelja e dispozitave mbi veterinarinë**

Shkelja e dispozitave mbi veterinarinë, në qoftë se kjo shkelje ka shkaktuar pasoja të rënda, dënohet:

me qortim shoqëror, me gjobë gjer në një mijë lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

### **Neni 172**

#### **Trajtimi i pakujdeshëm i gjësë së gjallë**

Trajtimi i pakujdeshëm i gjësë së gjallë, që është pasuri socialiste, kur nga ky trajtim janë shkaktuar pasoja të rënda dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 173**

#### **Prerja e paligjshme e pyjeve ose dëmtimi i tyre**

Prerja e paligjshme e pyjeve ose dëmtimi i tyre, kur vepra nuk formon kundërvajtje administrative, dënohet:

me gjobë gjer në një mijë lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

#### **Neni 174**

#### **Peshkimi i paligjshëm**

Peshkimi në dete, liqene, lumenj ose rezervuarë me mjete dhe mënyra të ndaluara, dënohet:

me qortim shoqëror, me gjobë gjer në një mijë lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

me gjobë gjer në pesëqind lejë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

Po kjo vepër, e kryer me dhunë, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

#### **Neni 184**

#### **Kanosja**

Kanosja serioze për vrasje ose për plagosje të rëndë që i bëhet një personi dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

#### **Neni 185**

#### **Fyerja**

Fyerja e një personi dënohet:

me qortim shoqëror, me gjobë gjer në pesëqind lekë, me riedukim nëpërmjet punës gjer në gjashtë muaj ose me heqje të lirisë gjer në gjashtë muaj.

Po kjo vepër, e bërë botërisht në dëm të disa personave ose më shumë se një herë dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një

vit.

### **Neni 186**

#### **Shpifja**

Përhapja e thënieve, që dihet se janë të rreme dhe që cenojnë nderin e dinjitetin e personit, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

Po kjo vepër, e bërë botërisht në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 187**

#### **Shkelja e fshehtësisë së korrespondencës**

Shkelja e fshehtësisë së korrespondencës dhe e mjeteve të tjera të komunikimit dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në gjashtë muaj.

### **Neni 188**

#### **Shkelja e të drejtave të gruas**

Pengimi me dashje i gruas për të gëzuar të drejta të barabarta me burrin në punë, në shpërblim, në sigurimin shoqëror-shtetëror, në arsim në tërë verpimtarinë shoqërore e politike dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 189**

#### **Fejesa e të miturve**

Fejesa e personave nën moshën e caktuar nga ligji për martesë ose shtytja për t'u fejuar nën këtë moshë, të bërë nga prindërit, kujdestari ose persona të tjerë, dënohen:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

### **Neni 190**

#### **Shpërblimi për martesë**

Dhënia e shpërblimit për martesë ose pranimi i tij dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

### **Neni 191**

#### **Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesën**

Shtrëngimi ose pengimi që i bëhet një gruaje për të vazhduar jetesën bashkëshortore ose shtrëngimi i saj për të zgjidhur martesën dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 192**

#### **Bashkëjetesa e ndaluar**

Mbajtja e marrëdhënieve bashkëshortore me një grua, pa u ngritur e pa u shqyrtuar nga gjykata padia për zgjidhjen e martesës ligjore, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

## **Neni 193**

Mbajtja në të njëjtën kohë e marrdhënieve bashkëshortore me dy ose më shumë gra dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

## **Neni 194**

### **Shkelja e detyrimeve familjare**

Mosdhënia e mjeteve të ushqimit fëmijëve, prindërve ose bashkëshortit të paaftë për punë, megjithë mundësitë e dhënies së tyre, si edhe lënia e fëmijëve të mitur pa asnjë përkrahje nga ana e prindërve dënohen:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës pse me heqje të lirisë gjer në një vit.

## **Kreu i tretë**

### **Kundërvajtje penale kundër pasurisë së shtetasve**

## **Neni 195**

### **Shpërdorimii pasurisë**

Shpërdorimi i pasurisë së tjetrit nga personi të cilit i është besuar për një qëllim të caktuar, edhe në qoftë se është kryer më shumë se njëherë dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

## **Neni 196**

### **Përvetësimi i një pasurie të gjetur**

Përvetësimi i pasurisë vetjake të gjetur oe të rënë më dorë

gabimisht ose rastësisht dënohet:  
me qortim shoqëror ose me riedukim nëpërmjet punës.

### **Neni 197**

#### **Falsifikimi i dokumenteve**

Falsifikimi, me qëllim përfitimi pasurie i dokumenteve të shtetasve dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 198**

#### **Blerja e pasurisë së shtetasve që rrjedh nga një krim ose pranimi i saj**

Blerja e pasurisë së shtetasve që dihet se rrjedh nga një krim ose pranimi i saj, edhe në qoftë se është kryer më shumë se një herë, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 199**

#### **Shkatërrimi ose dëmtimi i pasurisë së shtetasve nga pakujdesia**

Shkatërrimi ose dëmtimi i pasurisë së shtetasve nga pakujdesia me armë zjarri ose me mjet tjetër që sjell rrezik të përbashkët, në qoftë se këto vepra janë shkaktuar pasojë të rënda dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Kreu i katërt**

#### **Kundërvajtje penale lidhur me të drejtën e zgjedhjes**

## **Neni 200**

### **Ndalimi i ushtrimit të së drejtës së zgjedhjes**

Ndalimi i shtetasve që të ushtrojnë lirisht të drejtën të zgjedhin e të zgjidhen në organet shtetërore, vënia e zgjedhësve në listë ose përjashtimi prej sa pa të drejtë, si edhe shkelja e fshehtësisë së votimit nga ana e personit të ngarkuar me zgjedhjet dënen:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

## **Neni 201**

### **Falsifikimi i dokumenteve të zgjedhjeve**

Falsifikimi i dokumenteve të zgjedhjeve ose i rezultateve të votimit, i kryer nga ana e personit të ngarkuar me zgjedhjet, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

## **Kreu i pestë**

### **Kundërvajtje penale kundër drejtësisë**

## **Neni 202**

### **Dëshmia, ekspertimi ose përkthimi i rremë**

Dëshmia, ekspertimi ose përkthimi, që dihet se janë të rreme, të bërë përpara organeve të hetimit ose gjykatës, dënohen:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

## **Neni 203**

### **Morparaqitja e dëshmitarit, e ekspertit ose e përkthyesit**

Mosparaqitja e dëshmitarit, e ekspertit ose e përkthyesit, pa shkaqe të arsyeshme, në organet hetimore a gjyqësore ose mospranimi për të dëshmuar ose për të kryer detyrat e tyre dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në tre muaj.

## **Kreu i gjashtë**

### **Kundërvajtje penale kundër rendit administrativ**

#### **Neni 204**

##### **Kundërshtimi ndaj përfaqësuesit të shtetit**

Kundërshtimi, që i bëhet përfaqësuesit të shtetit, kur është duke kryer detyrën sipas ligjit dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

#### **Neni 205**

##### **Kundërshtimi ndaj aktivistëve shoqërorë**

Kundërshtimi ndaj aktivistëve shoqërorë që ushtrojnë kontrollin punëtor e fshatar dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

#### **Neni 206**

##### **Fyerja e personit për shkak të detyrës**

Fyerja e personit për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore a shoqërore ose në prodhim dënohet:

me gjobë gjer në pesëqind lekë, me riedukim nëpërmjet punës



ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

### **Neni 207**

#### **Kanosja për shkak të detyrës**

Kanosja serioze për vraske ose plagosje të rëndë, që i bëhet një personi për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore, shoqërore ose në prodhim, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 208**

#### **Përvetësimi i titullit ose i detyrës**

Përvetësimi oa të drejtë i titullit ose i detyrës së përfaqësuesit të shtetit, i shoqëroruar me verpime të paligjshme, dënohet:

me riedukim nëpërmjet unës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

### **Neni 209**

#### **Shmangia e parazitëve nga puna**

Moszbatimi nga ana e parazitëve i vendimit të organeve shtetërore për vendosjen në punë, i kryer më shumë se një herë dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës olse me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 210**

#### **Vetëgjyqësia**

Ushtrimi i një të drejte prej personit që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri, pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror, dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës gjer në gjashtë muaj ose me heqje të lirisë gjer në tre muaj.

### **Neni 211**

#### **Pengimet në ekzekutimin e vendimeve**

Fshehja, tjetërsimi, konsumimi, dëmtimi ose shkatërrimi i sendeve, për të cilat është marrë vendim prej gjykatës a prej një organi tjetër kompetent të pushtetit, ose kryerja e veprimeve të tjera, të bëra me qëllim që të mos ekzekutohet ose që të pengohet ekzekutimi i vendimit, dënhen:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 212**

#### **Përgatitja e vulave, e stampave ose e formularëve false**

Përgatitja, vënia në qarkullim ose përvetësimi i vulave, i stampave ose i formularëve të një institucioni ose ndërmarrjeje, për të bërë dokumente false dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 213**

#### **Mostregimi i emrit të anijes nga ana e kapitenit të saj**

Mostregimi nga ana e kapitenit të një anijeje i emrit dhe i portit të regjistrimit të saj, si dhe i vendit nga ishte nisur dhe për ku drejtohej, megjithëse ka pasur mundësi t'ia japë këto informata anijes tjetër me rastin e përplasjes në det me të dënohet:

me gjobë gjer në pesëqind lekë, me riedukim nëpërmjet punës, ose me heqje të lirisë der në tre muaj.

### **Neni 214**

## **Mosdhënia e ndihmës në raste përplasjeje anijesh**

Mosmarrja e masave të duhura nga kapiteni i njërës prej anijeve të përplasma në det për të shpëtuar anijen tjetër, kur këto masa mund të merreshin pa rrezik serioz për udhëtarët, ekuipazhin dhe anijen e vet, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në gjashtë muaj.

### **Neni 215**

#### **Përvetësimi, shkatërrimi ose dëmtimi i materialeve të arkivave**

Përvetësimi, shkatërrimi ose dëmtimi i materialeve të arkivave të shtetit dënohet:

me qortim shoqëror, me gjobë gjer në pesëqind lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 216**

#### **Dëmtimi ose shkatërrimi i monumenteve të kulturës**

Dëmtimi ose shkatërrimi i monumenteve të kulturës, që janë pasuri shtetërore ose që janë vënë nën mbrojtjen e shtetit, si edhe falsifikimi ose përdorimi i tyre i paligjshëm në dëm të vlerës së tyre shkencore, historike ose artistike, dënohet:

me qortim shoqëror, me gjobë gjer në pesëqind lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Kreu i shtatë**

#### **Kundërvajtje penale në fushën e mbrojtjes së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë**

### **Neni 217**

#### **Shmangia nga evidenca ushtarake**

Shmangia e shtetasit shqiptar (rezervist ose paraushtarak) nga regjistrimi ose mosbërja e ndryshimeve në evidencën ushtarake, kur kryhen më shumë se një herë, dënohet:

me gjobë gjer në pesëqind lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në gjashtë muaj.

### **Neni 218**

#### **Shmangia nga shërbimi ushtarak**

Shmangia ne shtetasit shqiptar nga thirrja në ushtri për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, dënohet:

me gjobë gjer në një mijë lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

Shmangia e shtetasit shqiptar nga thirrja për shërbim paraushtarak ose shmangia e shtetasit nga thirrja për stërvitje ushtarake a nga prova e gatishmërisë dhe e mobilizimit, kur kryhen më shumë se një herë dënohen:

me gjobë gjer në një mijë lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 219**

#### **Shmangia nga detyrimi për dorëzim kafshësh, mjetesh ose pajisjesh**

Shmangia nga detyrimi për dorëzimin e kafshëve, të mjeteve të transportit ose të pajisjeve për nevojat e forcave të armatosura dënohet:

me gjobë gjer në pesëqind lekë ose me riedukim nëpërmjet punës.

### **Neni 220**

#### **Hyrja pa leje në zonat ushtarake**

Hyrja pa leje në zonat kufitare ose në zona të tjera të ndaluara, dhënia e lejes një personi, përdorimi i lejes së huaj, mosregjistrimi i lejes, si edhe çdo shkelje tjetër e dispozitave në lidhje me lëvizjen dhe qëndrimin e shtetasve në këto zona, kur kjo nuk parashikohet si kundërvajtje administrative, dënohet: me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 221**

#### **Shkelja e dispozitave mbi përdorimin e radioinstalimeve**

Shkelja e dispozitave mbi përdorimin e radioinstalimeve në anijet dhe në aeroplanët shqiptarë ose në anijet dhe në aeroplanët e huaj, që ndodhen në ujërat ose në hapësirën ajrore të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, dënohet:

me gjobë gjer në një mijë lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 222**

#### **Heqja ose prishja e shenjave topografike**

Heqja ose prishja e shenjave të vendosura për qëllime topografike ose gjeodezike, me karakter të përhershëm ose të përkohshëm, ose vënia e paligjshme e shenjave të tilla dënohen:

me qortim shoqëror, me gjonbë gjer në pesëqind lekë ose me riedukim nëpërmjet punës gjer në gjashtë muaj.

### **Neni 223**

#### **Ngritja pa të drejtë e flamurit**

Ngritja e flamurit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në një anije detare tregtare, që nuk ka të drejtë ta mbajë këtë flamur dënohet:

me gjobë gjer në një mijë lekë ose me heqje të lirisë gjer në dy

vjet.

**Kreu i tetë**  
**Kundërvajtje penale kundër sigurimit shoqëror**

**Neni 224**  
**Prodhimi, mbajtja, bleja ose shitja e armëve**

Prodhimi, mbajtja, blerja ose shitja e armëve dhe e lëndëve plasëse pal ejen e organeve kompetente dënohen:  
me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

**Neni 225**  
**Shkelja e dispozitave mbi armët**

Shkelja e dispozitave mbi armët, kur si pasojë e veprimeve të një personi të papërgjegjshëm është shkaktuar plagosje e rëndë ose vdekje, dënohet:  
me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

**Neni 226**  
**Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse**

Shkelja e rregullave të caktuara për prodhimin, ruajtjen, dërgimin ose transportimin e lëndëve plasëse, djegëse ose readioaktive, dënohet:  
me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

**Neni 227**  
**Shkelja e rregullave mbi lëndët helmuese**

Shkelja e rregullave të caktuara për prodhimin, ruajtjen, furnizimin dhe transportimin e lëndëve helmuese me efekt të fortë, kur ka sjellë pasoja të rënda , dënohet:

me gobë gjer në një mijë lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

### **Neni 228**

#### **Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë**

Shkelja e rregullave të teknikës së sigurimit, të higjienës ose e rregullave të tjera të mbrojtjes në punë, në qoftë se kjo shkelje ka krijuar rrezik për jetën ose për shëndetin e punonjësve, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

### **Neni 229**

#### **Shkelja e të drejtave të punonjësve**

Veprimi arbitrar, propotent, si edhe çdo shkelje tjetër e kryer me dashje nga ana e drejtuesve të ndërmarrjeve, të institucioneve ose të organizatave ndaj të drejtave që u janë njohur punonjësve nga Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe, në zbatim të saj, nga dispozitat e tjera ligjore në fushën e marrëdhënieve të punës, dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në gjashtë muaj.

### **Neni 230**

#### **Shkelja e rregullit në prodhim**

Pirja e duhanit, paraqitja në gjendje të dehur ose fjetja gjatë prodhimit në repartet ku ka rrezik plasjeje dënohet:

me gjobë gjer në pesëqind lekë, me riedukim nëpërmjet punës

ose me heqje të lirisë deri në gjashtë muaj.

### **Neni 231**

#### **Shkelja e rregullave në punime**

Shkelja e rregullave të ndërtimit, të higjienës ose kundër zjarrit, të caktuara për punimet e ndërtimit ose për sigurimin në minierë, dënohet:

me gjobë gjr në pesëqind lekë, me riedukim, nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në gjashtë muaj.

### **Neni 232**

#### **Shkelja e rregullave për sigurimin nga zjarri**

Shkelja e rregullave për sigurimin nga zjarri nga ana e pesonave të ngarkuar, kur janë shkaktuar pasoja të rënda, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Kreu i nëntë**

#### **Kundërvajtje penale në fushën e shëndetësisë**

### **Neni 233**

#### **Ushtrimi i mjekësisë pa të drejtë**

Ushtrimi i mjekësisë si profesion nga një person që nuk e ka të drejtë dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 234**



## **Përgatitja dhe shitja e prodhimeve ushqimore të rrezikshme për shëndetin**

Përgatitja, mbajtja me qëllim shitjeje, shitja e prodhimeve ushqimore dhe e pijeve të rrezikshme ose të dëmshme për shëndetin, kur këto vepra nuk parashikohen si kundërvajtje administrative, dënohen:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjër në një vit.

### **Neni 235**

#### **Ndotja e ambientit**

Shkelja e dispozitave lidhur me mbrojtjen e tokës, të pasurive të natyrës, të ujërave dhe të ajrit nga prishja dhe ndotja, kur janë shkaktuar pasoja të rënda, dënohet:

me qortim shoqëror ose me gjobë gjër në një mijë lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjër në dy vjet.

### **Kreu i dhjetë**

#### **Kundërvajtje penale kundër moralit shoqëror**

### **Neni 236**

#### **Luajtja e bixhozit**

Luajtja e bixhozit dënohet:

me gjobë gjër në një mijë lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjër në dy vjet.

### **Kreu i njëmbëdhjetë**

#### **Kundërvajtje penale ushtarake**

### **Neni 237**

## **Largimi pa leje**

Largimi pa leje i ushtarakut nga reparti ose vendi i shërbimit për një kohë më tepër se 24 orë ose më shumë se një herë për një kohë edhe më pak se 24 orë dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit, dhe kur ka rrethana lehtësuese, zbatohet “Rregullorja e disiplinës e Ushtrisë Popullore”.

Po kjo vepër, e kryer nga oficerët dhe nënoficerët për një kohë më tepër se tri ditë ose më shumë se një herë për një kohë edhe më pak se tri ditë, dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

## **Neni 238**

### **Mosparaqitja në repart ose në vendin e shërbimit**

Mosparaqitja e ushtarëve dhe e nënoficerëve të shërbimit të detyruar ushtarak, pa shkaqet të arsyeshme, në repart ose në vendin e shërbimit, për një kohë më tepër se 24 orë ose më shumë se një herë për një kohë edhe më pak se 24 orë dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në gjashtë muaj, dhe kur ka rrethana lehtësuese, zbatohet “Rregullorja e disiplinës e Ushtrisë Popullore”.

Po kjo vepër, e kryer nga oficerët dhe nënoficerët e shërbimit aktiv për një kohë më tepër se tri ditë ose më shumë se një herë për një kohë edhe më pak se tri ditë, dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

## **Neni 239**

### **Largimi pa leje i të thirrurve në stërvitje**

Largimi pa leje i ushtarakëve të thirrur në stërvitje ushtarake ose mosparaqitja e tyre në kohën e caktuar në repart ose në vendin e

shërbimit pa shkaqe të arsyeshme dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në gjashtë muaj dhe, kur ka rrethana lehtësuese, zbatohet “Rregullorja e disiplinës e Ushtrisë Popullore”.

### **Neni 240**

#### **Moszbatimi i urdhrit**

Moszbatimi i urdhër shërbimit dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

Kur ka rrethana lehtësuese, zbatohet “Rregullorja e disiplinës e ushtrisë Popullore”.

### **Neni 241**

#### **Vepra diskredituese për ushtrinë**

Kryerja nga ana e njëushtaraku e veprave që ulin haptazi prestigjin dhe autoritetin e ushtrisë dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 242**

#### **Vepra diskredituese për ushtrinë**

Kryerja nga ana e një ushtaraku e veprave që ulin haptazi prestigjin dhe autoritetin e ushtrisë dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

### **Neni 243**

#### **Moscaktimi i rojave**

Moscaktimi ose mosnxjerrja e rojave dhe e personave për shoqërimin, pa shkaqet të arsyeshme, dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës opse me heqje të lirisë gjer në një vit.

#### **Neni 244**

### **Shkelja e rregullave të shërbimit të rojës**

Shkelja e rregullave të shërbimit të rojës nga ushtaraku i ngarkuar për të ruajtur objekte të caktuara ose me detyrë shoqërimi dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet,

#### **Neni 245**

### **Dëmtimi i armatimeve nga pakujdesia**

Dëmtimi nga pakujdesia i armatimeve, i teknikës luftarake ose i mjeteve të komunikacionit dhe të ndërlidhjes, të dhëna në ruajtje ose në përdorim dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

#### **Neni 246**

### **Shpërdorimi, shkatërrimi ose dëmtimi i sendeve të veshmbathjes**

Shpërdorimi, shkatërrimi ose dëmtimi me dashje i sendeve të veshmbathjes, të dhëna për ruajtje ose për përdorim, dënohet:

me qortim shoqëror, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

#### **Neni 247**

## **Dispozita të fundit**

Kodi Penal i mirtuar me ligjin nr.1516, datë 7 gusht 1952 me ndryshimet e mëvonshme, si edhe dispozitat e tjera që parashikojnë vepra penale, shfuqizohen.

### **Neni 248**

Ky Kod hyn në fuqi më 1 tetor 1977.

SEKRETARI I PRESIDUMIT TË KUVENDIT  
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE  
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

TELO MEZINI

KREYTARI I PRESIDUMIT TË KUVENDIT  
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE  
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

HAXHI LLESHI